



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 3046/3 Prot.

Vlorë më, 26.11.2025

VENDIM

Nr. 114, datë 26.11.2025

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT, MASTER PROFESIONAL NË
"MEDIA NË MARRËDHËNIE PUBLIKE DHE ADMINISTRIMIN E OBJEKTEVE
TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE" PËR VITIN AKADEMIK
2026-2027 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja 'dh' dhe nenit 75 të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja 'ë' dhe nenit 59 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; neni 13, pika 22, neni 55 dhe 69 të Rregullores së Brendshme të UV-së; Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve" (i ndryshuar); VKM-së Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar; si dhe referuar propozimit të Fakultetit të Shkencave Humane përcjellë me shkresën nr. 1009/3 Prot., datë 25.11.2025; dhe relaconit të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike, përcjellë me shkresën 2013/1 prot., datë 25.11.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.11.2025,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Gjuhë-Letërsisë, në Fakultetin e Shkencave Humane, për hapjen e programit të ri të studimit, Master Profesional në "Media në Marrëdhënie Publike dhe Administrimin e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike dhe Drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Humane.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

